



KOMITETI OLIMPIK
KOMBËTAR SHQIPTAR

NJOFTIM PËR TRAJNER PER PROJEKTIN “EKIPET SPORTIVE NE SHKOLLA”

“Trajner per Disiplinen e Shahut” (Qytetet: TIRANË,DURRËS,LEZHË,VLORË)

Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar (KOKSH) është një organizatë sportive Kombëtare e pavarur, themeluar në vitin 1958, pa qëllim fitimi, e organizuar mbi bazën e parimeve të Kartës Olimpike, dhe që funksionon sipas statutit të saj. KOKSH është organizata e vetme që përfaqëson Lëvizjen Olimpike Shqiptare, parimet e së cilës janë të detyrueshme për tu zbatuar nga të gjithë anëtarët e saj.

Në kuadër të Projektit “Ekipet Sportive ne Shkolla”, projekt i financuar nga Buxheti i Shtetit, KOKSH, fton kandidatët e interesuar për të aplikuar për Trajnerë Shahu pjesë të Projektit Ekipave Sportive në Shkolla.

Objektivi i përgjithshëm i Projektit është krijimi i një Programi Kombëtar që nxit 1) sportin masiv, 2) zbulimin e talenteve, 3) edukatën sportive dhe parimet olimpike. Projekti do të formojë Ekipet sportive jashtë shkollore në nivelin 9-vjecar dhe në nivelin shkollë e mesme.

Detyrat e Trajnerit:

Rregullat e Përgjithshme:

- Trajnerët duhet të kenë njohuri të rregullave të FIDE (Federata Ndërkombëtare e Shahut).
- Të planifikojë dhe të zhvillojë seanca trajnimi sipas niveleve të nxënësve (fillestarë, të mesëm, të avancuar).
- Të përdorë metoda interaktive dhe të përshtatshme për moshat e ndryshme.
- Të udhëheqë lojëra praktike dhe festivale të brendshëm për të stimuluar konkurrencën e shëndetshme.
- Të monitorojë përparimin individual të nxënësve dhe të mbajë shënime mbi zhvillimin e tyre.
- Të promovojë vlera si durimi, përqendrimi, respekti dhe vendimmarrja.
- Të përgatisë nxënësit për pjesëmarrje në festivale lokale, kombëtare.

Kualifikimet dhe Eksperienca:

- Eksperiencë në mësimdhënie ose trajnim shahu për fëmijë dhe të rinj.
- Të ketë kualifikime nga Federata Shqiptare e Shahut.
- Njohuri të mira të teorisë së shahut dhe rregullave të tij (nivel i certifikuar preferohet).
- Aftësi komunikimi dhe durim në punë me fëmijët.
- Aftësi organizative dhe kreative në përgatitjen e orëve mësimore.
- Preferohet diplomë në arsim, edukim sportiv ose certifikata trajnimi nga federata shahu.
- Aftësi për të përdorur mjete teknologjike në mësimdhënie (tabela dixhitale, aplikacione shahu online, etj.)

Kandidatet e interesuar mund të shprehin interesin e tyre brenda një afati 2 javor nga dalja e këtij njoftimi ne email secretary.general@nocalbania.org.al ose prane zyrave te KOKSH.